

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-94445
Më 31.7.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31.7.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për menaxhimin e mbeturinave, dhe mori këtë

KON KLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Prizrenit, kështu që për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramdan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-94445
Më 31.7.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31.7.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për rehabilitimin e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit në fshatin Mushnikovë, dhe mori këtë

KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e rehabilitimit të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit në fshatin Mushnikovë, kështu që për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Vreca



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-94445
Më 31.7.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31.7.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin me elemente të betonit të rrugës “Flamuri, dhe mori këtë

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e ndërtimit me elemente të betonit të rrugës “Flamuri”-ish “Nëna Terezë”, kështu që për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Dok. Nr. Ramadan Vuja

The image shows a circular official stamp of the Prizren Municipality. The stamp contains the text "REPUBLIKA E KOSOVËS" at the top, "KOMUNA E PRIZRENIT" at the bottom, and "PRIZREN BELEDIYESI" in the center. There is a central emblem featuring a building. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in black ink.

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-94937
Më 31.7.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejjimin e mjeteve për përkrahje financiare për Kryqin e Kuq të Kosovës-dega në Prizren, kryetari i Komunës, më 31 korrik 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejjimin e mjeteve për përkrahje financiare për Kryqin e Kuq të Kosovës-dega në Prizren, me qëllim të organizimit të fushatës vetëdijësuese për rrezikun nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera i cili organizim mbahet me 13 tetor 2014 në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të Zvogëlimit të Rrezikut dhe Fatkeqësitë”, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën prej 295 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe mallrave dhe shërbimeve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Kamadan Maja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-94445
Më 31.7.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31.7.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për rregullimin e hapësirave publike te Gjimnazi “Remzi Ademaj”, dhe mori këtë

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e rregullimit të hapësirave publike te Gjimnazi “Remzi Ademaj” në Prizren, kështu që për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. Sh. Ramadan Muja

The image shows a circular official stamp of the Prizren Municipality. The stamp contains the text "REPUBLIKA E KOSOVËS" at the top, "KOMUNA E PRIZRENIT" at the bottom, and "PRIZREN" in the center. There is a handwritten signature in black ink over the stamp.

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-94445
Më 31.7.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31.7.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e kanalizimit në rrugën “Behajdin Hallaqi”, dhe mori këtë

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e ndërtimit të kanalizimit në rrugën “Behajdin Hallaqi” në Prizren, kështu që për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadani Ajllari

The image shows a circular official stamp of the Prizren Municipality. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E KOSOVËS", "KOMUNA E PRIZRENIT", "BELEDIJA E PRIZRENIT", "PRIZREN", "KOSOVA", and "Kryetari i Komunës". A handwritten signature in black ink is written over the stamp.

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-94445
Më 31.7.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31.7.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e shpalljes së tenderit për rregullimin e kabineteve, renovimin e brendshëm, lyerjen si dhe rregullimin njeve sanitare të shkollës së mesme ekonomike “Ymer Prizreni”, dhe mori këtë

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e rregullimit të kabineteve, renovimin e brendshëm, lyerjen si dhe rregullimin njeve sanitare të shkollës së mesme ekonomike “Ymer Prizreni”, kështu që për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Vllahi

The image shows a circular official stamp of the Prizren Municipality. The stamp contains the text "REPUBLIKA E KOSOVËS" at the top, "KOMUNA E PRIZRENIT" in the middle, and "KRYETARI I KOMUNËS" at the bottom. In the center of the stamp is a small emblem. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in black ink, which appears to be "Prof. Dr. Ramadan Vllahi".

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-94445
Më 31.7.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31.7.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës për lejimin e shpalljes së tenderit për transportin e nxënësve udhëtar të disa shkollave të Komunës së Prizrenit, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, i datës 22.7.2014, dhe lejohet shpallja e tenderit për transportin (bartjen) e nxënësve udhëtar të disa shkollave fillore të Komunës së Prizrenit, për periudhën shtator 2014-qershor 2015 dhe atë nxënësit e:

- a. ShFMU “Heronjët e Lumës” nga Dobrushti (44 nxënës),
- b. ShFMU “V.Frashëri” Guruzhub-Planej-anasjelltas (34 nxënës),
- c. ShFMU “Zenun Çoçaj” Tupec –Gjonaj (26 nxënës),
- d. ShFMU “Meto Bajraktari” Llokvicë, Gornja Sellë, Mushnikovë-Reqan, (36 nxënës),
- e. ShFMU “Zef Lush Marku” Smaç-Velezhë, (11 nxënës),
- f. ShFMU “Mithat Frashëri” Bregdri-Krajk (22 nxënës).

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdeset Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadani

The image shows a circular official stamp of the Prizren Municipality. The outer ring contains the text "REPUBLIKA E KOSOVËS" at the top and "KOMUNA E PRIZRENIT" at the bottom. Inside the ring, it says "OPSTINA PRIZREN" and "PRIZREN BELEGJE". The center of the stamp features a coat of arms. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in black ink, which appears to be "Prof. Dr. Ramadani".

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-94946
Më 31.7.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, më 31 korrik 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për në qytetin Forli të Italisë të 6 nxënësve dhe drejtorit të ShMM "Lorenc Antoni" kështu që, në emër të mbulimit të shpenzimeve të udhëtimit lejohen mjetet në shumën prej 1400 €.

Vizita do të realizohet prej datës 21 gusht deri me 30 gusht 2014,

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe mallrave dhe shërbimeve të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, ShMM "Lorenc Antoni" si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Vllahi



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-94953
Më 31.7.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e mjeteve për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit, për Haki Gajrakun, kryetari i Komunës më 31 korrik 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e mjeteve për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit, për Haki Gajrakun, drejtor i ShFMU "Ibrahim Fehmiu" në Prizren, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të mjekimit lejohen mjetet në shumën prej 1000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Bajta


The image shows the official seal of the Prizren Municipality, which is circular and contains the text "REPUBLIKA E KOSOVËS" at the top, "KOMUNA E PRIZRENIT" at the bottom, and "PRIZREN" in the center. Overlaid on the seal is a handwritten signature in black ink, which appears to be "Prof. Dr. Ramadan Bajta".

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-94959
Më 31.7.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për përkrahje financiare për KF "Liria", kryetari i Komunës më 31 korrik 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 29.7.2014, për përkrahje financiare për KF "Liria", me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për nevojat e klubit, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjete financiare në lartësi prej 9500 €.
- II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve të Komunës së Prizrenit.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave.
- IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave, KF "Liria", si dhe arkivi.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-94965
Më 31.7.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë për lejimin të mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të 27 pacientëve, kryetari i Komunës më 31 korrik 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, i datës 29.7.2014, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të pacientëve: 1.Violeta Laho, 2. Nefija Bajramović, 3. Hajrulla Selmanaj, 4. Mybera Shero, 5. Alije Selimi, 6. Tereze Shtufi, 7. Shemsije Rexhbeçaj, 8. Raifa Aliti, 9. Naxhi Bahtijari, 10. Resmije Hyseni, 11. Nimete Muji, 12. Pesent Sejdulla, 13. Sanije Kafexholli, 14. Hanemsha Skenderi, 15). Nesim Halimi, 16. Saide Rustemi, 17. Vasije Susuri, 18. Ilmije Rapi, 19. Hatije Saramati, 20. Shaban Kraji, 21. Llumturije Rrotlla, 22. Naile Qareti, 23. Amet Shaipi, 24. Dafina Morina, 25. Myrvet Spahi, 26. Hyrmet Shuki, dhe 27. Shaqir Thaqi.

Për këtë qëllim, lejohen mjetet në lartësi prej 300 € për secilin prej të lartpërmendurve.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve i Drejtorisë së Shëndetësisë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-94968
Më 31.7.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit, për Ylber Gashin, zyrtar komunal, kryetari i Komunës më 31 korrik 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit, për Ylber Gashin, zyrtar komunal pran DUPH, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të mjekimit lejohen mjetet në shumën prej 1000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve dhe atë:

- a. Prej pozicioneve të Drejtorisë së Shëndetësisë lejohen mjetet në shumën prej 500 €, dhe
- b. Prej pozicioneve të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor lejohen mjete në shumën prej 500 €.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-94969

Më 31.7.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve për mbulimin e pjesëshëm të shpenzimeve të mjekimit, për Ismet Ramën, zyrtar komunal, kryetari i Komunës më 31 korrik 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve për mbulimin e pjesëshëm të shpenzimeve të mjekimit, për Ismet Ramën, zyrtar komunal pran DEF, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të mjekimit lejohen mjetet në shumën prej 500 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Shëndetësisë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtorja e Shëndetësisë dhe Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtorja e Shëndetësisë, Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-94445
Më 31.7.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31.7.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me veshmbathje për stafin e shëndetësisë primar, dhe mori këtë

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e furnizimit me veshmbathje për stafin e shëndetësisë primar, kështu që për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-94973
Më 31.7.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit nr. 04/L-066, dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit kryetari i Komunës, më 31 korrik 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Caktohet inspektori për mbikëqyrjen e aktiviteteve dhe zhvillimeve në Qendrën Historike të Prizrenit.
- II. Inspektor për Qendrën Historike të Prizrenit caktohet Enver Bytyqi, inspektor i ndërtimtarisë në Drejtorinë e Inspektorateve të Komunës së Prizrenit.
- III. Inspektori i caktuar përpos kompetencave lëndore që dalin nga Ligji për Ndërtim dhe ligjet tjera ka kompetenca edhe nga fusha e urbanizmit, trashëgimisë kulturore dhe shërbime publike.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Drejtoria e Inspektorateve.
- V. Me këtë vendim të njoftohen Drejtoria e Inspektorateve, organet kompetente, dhe i lartcekuri.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-94445
Më 31.7.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31.7.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Inspektorateve, për lejimin e shpalljes së tenderit për largimin e mbeturinave nga hapësira publike-hekurudha, dhe mori këtë

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Inspektorateve, për lejimin e largimit të mbeturinave nga hapësira publike-hekurudha në pjesën e qytetit të Prizrenit, kështu që për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Inspektorateve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Inspektorateve, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.


Kryetari i Komunës
Brosnim Karaman


REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-94445
Më 31.7.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje nr. 04/L-188, dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, kryetari i Komunës, më 31 korrik 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet Task Forca për implementimin e Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje nr. 04/L-188.
- II. Lejohet hapja e konkursit për pranimin e 10 deri në 12 ekspertëve, për kohë të caktuar, me qëllim të zbatimit efektiv dhe efikas brenda kohës së lejuar të Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje nr. 04/L-188.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Zyra e Personelit dhe drejtoritë tjera komunale.
- IV. Me këtë vendim të njoftohen Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Zyra e Personelit, drejtoritë tjera komunale, dhe Arkivi.



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-94445

Më 31.7.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31.7.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e projektit Kampusi i Universitetit të Prizrenit, dhe mori këtë

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e hartimit të projektit Kampusi i Universitetit të Prizrenit, kështu që për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Myta



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-94445

Më 31.7.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31.7.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e projektit për ndërtimin e shkallëve lëvizëse për në Kalanë e qytetit, dhe mori këtë

KON KLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e hartimit të projektit për ndërtimin e shkallëve lëvizëse për në Kalanë e qytetit, kështu që për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan

The stamp is circular and contains the following text: "REPUBLIKA E KOSOVËS" at the top, "KOMUNA E PRIZRENIT" in the middle, and "PRIZREN" at the bottom. It also features a central emblem and the words "Kryetari i Komunës" and "Prof. Dr. Ramadan" written over it.

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-94445

Më 31.7.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31.7.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e shpalljes së tenderit për hapjen e rrugëve në lokacionin ku është hartuar Plani Rregullues (i hollësishëm) Urban, për lokacionin ku është paraparë Zona Industriale dhe Terminali i qytetit të Prizrenit, dhe mori këtë

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e hapjes së rrugëve në lokacionin ku është hartuar Plani Rregullues (i hollësishëm) Urban, për lokacionin ku është paraparë Zona Industriale dhe Terminali i qytetit të Prizrenit, kështu që për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Mulla

